

MENDIM PAKICE

Si anëtare e trupit gjykues nuk pajtohem me vendimin e shumicës së trupit gjykues për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Madani, me detyrë prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në të tria kriteret e rivlerësimit, konkretisht, atë të rivlerësimit të pasurisë, sipas pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme: a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; b) kur arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; c) kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.”

Sipas vlerësimit tim si anëtare në pakicë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, referuar pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për arsyet e mëposhtme:

1. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 146.46 m² plus garazhin me sipërfaqe 10.5 m²

1.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka në bashkëpronësi me bashkëshorten një apartament me sip. 146.46 m², së bashku me garazhin me sip. 10.5 m², me adresë: Rr. “****”, pallati “****”, Durrës, si dhe deklaroi se vlera totale e pasurive të mësipërme, sipas aktit të porosisë të bërë në vitin 2001, është 5,500,000 lekë, ndërsa për arsye të mospërfundimit të banesës, në aktet e shitblerjes vlera e apartamentit (karabina) është 1,700,000 lekë dhe vlera e garazhit është 250,000 lekë, shpenzime të cilat janë kryer më pas për punimet.

Ndërkohë që ky deklaram bie ndesh me provat shkresore dhe deklaramet e subjektit gjatë hetimit dhe atyre vjetore:

1.2 Deklaratën e vitit 2003, dorëzuar në datën 24.3.2004, ku subjekti deklaroi se ka në pronësi një apartament banimi 3+1, në vlerën 5,500,000 lekë dhe nuk ka deklaruar se ky apartament është në gjendje karabinaje. Për më tepër, nuk ka deklaruar se priten punime ndërtimi për ta përfunduar. Gjithashtu, në deklaratën e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar garazhin, i cili në kohën e deklaramit, sipas përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, ishte likuiduar totalisht.

1.3 Kontratën e shitblerjes së datës 1.10.2004, jo para noterit publik, ku vlera e apartamentit është përcaktuar 1,700,000 lekë, duke mos cituar gjendjen karabina të këtij apartamenti.

1.4 Deklaramin e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit, se nuk e ka ditur që shtëpia dhe garazhi ishin trajtuar në kontrata si pasuri të ndara nga njëra-tjetra, bie ndesh me provat e administruara/dy kontratave të nënshkruara nga subjekti, ku njëra është për apartamentin në shumën 1,700,000 lekë dhe tjetra për garazhin për një shumë prej 250,000 lekësh, të dyja jo para noterit dhe të nënshkruara në të njëjtën datë, 1.10.2004.

1.5 Vendimin nr. ***, datë 31.8.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrësit, e cila, në lidhje me kërkesëpadinë e shoqërisë “****” sh.p.k., që kërkonte regjistrimin në ZVRPP, vendosi të pranojë kërkesën duke urdhëruar ZVRPP-në të regjistronte ndërtesën, pasi ishin përmbushur të gjitha kërkesat ligjore për regjistrimin.

1.6 Dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Durrës¹, vërtetim nr. ***, datë 6.12.2001, nga dokumenti hipotekor, i cili vërteton se kjo pronë ka qenë e regjistruar që në vitin 2001.

1.7 Deklaratën e vitit 2003, e dorëzuar në mars të vitit 2004, në të cilën subjekti i rivlerësimit deklaron si adresë banimi, adresën e këtij apartamenti të ndodhur në lagjen nr. ***, Rr. “****”, pallati “****”, Durrës.

1.8 Deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, në të cilën subjekti nuk ka deklaruar kontratën e shitblerjes së apartamentit në datën 1.10.2004, në vlerën 1,700,000 lekë dhe garazhit në datën 1.10.2004, në vlerën 250,000 lekë.

1.9 Deklarimet e subjektit në përgjigje të pyetjeve shtesë gjatë hetimit administrativ, në të cilin deklaron se pagesa për shoqërinë “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit + garazh në qytetin e Durrësit, është bërë në dy këste, kësti i parë, në vlerën 1,000,000 lekë është paguar menjëherë pas marrëveshjes verbale në fund të vitit 2001 (periudha nëntor – dhjetor) dhe kësti i dytë, në shumën 950,000 lekë, është paguar në fund të vitit 2002 (nëntor – dhjetor 2002).

Si konkluzion, në lidhje me deklarimin e këtyre dy pasurive, unë si anëtare në pakicë arrij në përfundimin se:

- i. subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, si dhe ka kryer deklaram të rremë në lidhje me këto dy pasuri (apartamenti dhe garazhi);**
- ii. subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë dhe ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi (apartamentin dhe garazhin) dhe pas kalimit të barrës së provës nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultatit të Komisionit.**

Burimi i krijimit të këtyre pasurive (apartament + garazh)

1.10 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaron se si burim për krijimin e këtyre dy pasurive janë kursimet ndër vite të të ardhurave dhe pjesëtimi vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000.

1.11 Në deklaratën për herë të parë në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit deklaron se si burim për krijimin e apartamentit është pjesëtimi vullnetar nga shitja e banesës në bashkëpronësi dhe kursimet ndër vite.

Ndërkohë që ky deklaram bie ndesh me provat shkresore dhe deklaramet e subjektit gjatë hetimit dhe atyre vjetore:

¹ Me shkresat nr. ***prot., dhe nr. *** prot., datë 3.5.2018.

1.12 Deklarimin e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 5, datë 21.11.2018, gjatë hetimit administrativ, i cili deklaroi se babai i tij, z. S.M., i ka dhuruar shumën prej 1,500,000 lekësh, të përfituara nga kontrata e shitjes së apartamentit në vitin 2000.

1.13 Deklarimin e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit se si burim tjetër shtesë nga ato që kishte deklaruar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, kanë shërbyer ndihmat nga prindërit e bashkëshortes dhe nga i vëllai, A., (emigrant nga viti 1992 e në vazhdim dhe sot), herë pas here për plotësimin e nevojave të ndryshme në formë dhurate, apo në fillimet e martesës dhe blerjes së banesës për punimet e kryera për përfundimin e saj.

Si konkluzion, në lidhje me deklarin e burimit të krijimit të këtyre pasurive, unë si anëtare në pakicë arrij në përfundimin se:

Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, si dhe ka kryer deklarin të rremë në lidhje me burimin që ka shërbyer për krijimin e këtyre dy pasurive (apartamenti dhe garazhi).

1.14 **Në lidhje me mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e të ardhurave** që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në shumën 5,500,000 lekë në vitin 2003, unë si anëtare në pakicë, për efekt të analizës financiare, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, marr në konsideratë si burim krijimi vetëm të ardhurat të cilat janë deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe atë periodike të vitit 2003 që janë të ardhurat nga pjesëtimi i të ardhurave të përfituara nga babai i subjektit për shitjen e apartamentit, plus kursimet ndër vite, si më poshtë vijon:

- i. Të ardhura nga vitit 1992 deri në vitin 2003, në shumën 3,982,359 lekë, sipas dokumentacionit ligjor justifikues, të ardhurat nga paga. Të ardhurat në shumën 475,000 lekë, të përfituara nga $\frac{1}{4}$ pjesë takuese e subjektit nga shitja² e llojit shtëpi banimi të ndodhur në Durrës, për vlerën 1,900,000 lekë, në datën 22.12.2000, nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. S.M.
- ii. Në lidhje me shpenzimet për jetesë për vitet 1997 – 2003, deklaruar plus sipas shkresës së ILDKPKI-së (INSTAT), në shumën 1,905,312 lekë, pa përfshirë këtu shpenzimet nga viti 1992 – 1997. Si shpenzim tjetër është shuma 120,000 lekë që është përdorur për arredimin, sipas deklarin të subjektit.

1.15 Duke vlerësuar provat dhe të dhënat në sa më lart, unë si anëtare në pakicë i referohem analizës financiare si më poshtë vijon:

Analiza financiare për periudhën 1992 – 2003	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat vetëm subjekti	4,099,659
Dhurime në cash babai nga shitja e shtëpisë	1,500,000
Total të ardhurat	5,599, 659

² Kontrata nr. ***, datë 22.12.2000.

Arredime deklaruar	120,000
Shpenzime për jetesë, 1997 – 2003, deklaruar + ILDKPKI (INSTAT)	1,905,312
Total shpenzime	2,025,312
Ndryshim mjete monetare deklaruar, 1.1.1992 – 31.12.2003	0
Mjete monetare të disponueshme (1)	3,574,347
Pagesë për blerje dhe krijim pasurie apartament + garazh	5,500,000
Total pagesë për pasuri	5,500,000
Detyrime 31.12.2003	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	5,500,000
Balanca e fondeve (1-2)	-1,925,653

1.16 Si konkluzion, në sa më lart, subjekti i rivlerësimit, për të ardhurat nga viti 1992 deri në vitin 2003, por me shpenzime nga viti 1997 deri në vitin 2003, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën - 2,950,653 lekë, për të justifikuar blerjen e apartamentit dhe garazhit.

1.17 Në lidhje me provat e marra në konsideratë nga shumica në analizën financiare të kryer në lidhje me dhurimet *cash* nga babai i subjektit në shumën 1,025,000 lekë (1,500,000 lekë – 475,000 lekë), dhurimet *cash* nga vjehri në shumën 1,000,000 lekë, dhurimet *cash* dhe të ardhurat nga bashkëshortja në shumën 350,000 lekë dhe dhurimin në natyrë të kumatit në shumën 300,000 lekë, unë si anëtare në pakicë vlerësoj se për të gjitha këto të ardhura të deklaruara si dhurime, në prapësimet e barrës së provës, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk justifikuan ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave.

1.18 Sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*”.

1.19 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të këtyre të ardhurave, si dhe nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, “*Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.*”

1.20 Subjekti i rivlerësimit, jo vetëm që nuk arriti të prapësonte mjaftueshëm konkluzionet e Komisionit, por nxori në pah mospërputhje të tjera, si më poshtë vijon:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë pjesëtimin vullnetar, atë që po ai vetë ka shpjeguar më pas se është një dhurim i marrë nga i ati. Më pas, ky deklarim ka ndryshuar përsëri, pasi babai i subjektit ka deklaruar se dhurimi i shumës prej 1,500,000 lekësh nuk është përfituar vetëm nga shitja e shtëpisë së familjes, por edhe nga remitancat/kursimet e vëllait të subjektit të rivlerësimit, sipas deklaratë së vitit 2018.
- ii. Gjatë seancës së zhvilluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ra në kontradiktë me deklaratimet e tij të mëparshme dhe me vetë avokatin e tij, duke deklaruar se pagesa e kësteve ka ndodhur në vitet 2002 dhe 2003 dhe jo në vitet 2001 dhe 2002 (siç kishte deklaruar më parë).
- iii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në asnjë nga deklaratimet e tij shumën e saktë për secilin nga burimet e financimit të apartamentit.
- iv. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar dhurimin e shumës prej 300,000 lekësh nga kunati, siç dhe ai pretendoi gjatë prapësimeve, duke rënë ndesh me përgjigjen e tij gjatë hetimit se shumën prej 300,000 lekësh e ka quajtur “dhurim në natyrë”, por më vonë e ka përshkruar si kontribut monetar për përfundimin e ndërtimit. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm se përse nuk e kishte deklaruar këtë dhurim më parë.
- v. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë legjitimitetin dhe ligjshmërinë e burimeve të financimit të kësaj pasurie, si ato të deklaruara në deklaratat, ashtu edhe ato të deklaruara për herë të parë gjatë dhe pas hetimit administrativ, duke mos dhënë prova bindëse, me anë të të cilave të justifikonte mungesën e deklaratimit të këtyre burimeve, si dhe/ose aftësinë financiare të secilit prej dhuruesve dhe huadhënësve.

2. Likuiditetet

2.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë në “Raiffeisen Bank” (fond investimi), me vlerë 5,500,000 lekë dhe gjendje *cash* në banesë në shumën 1,200,000 lekë. Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar kursimet e të ardhurave të tij dhe të bashkëshortes.

2.2 Nga analiza financiare e viteve 2003 – 2016, në fazën e përfundimit të hetimit kryesisht, u konstatua se subjekti i rivlerësimit kishte një balancë negative të akumuluar në shumën 2,700,059 lekë sipas tabelës më poshtë:

Viti	Mungesa e fondeve në lekë
2004	-298,260
2005	-459,614
2006	-433,043
2007	-490,661
2009	-95,366

2010	-487,531
2011	-119,043
2014	-142,514
2015	-174,027
Totali	- 2,700,059

2.3 Me rezultatet e hetimit kryesisht, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit, duke i kërkuar të shpjegonte dhe të provonte se ai kishte të ardhura nga burime të ligjshme për të krijuar gjendjen *cash* gjatë viteve 2004, 2005, 2006, 2007, 2009, 2010, 2011 , 2014 dhe 2015, duke qenë se nga analiza financiare rezultonte se kishte një balancë negative prej – 2,700,059 lekësh.

2.4 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, nuk provoi dot të kundërtën e rezultateve të hetimit. Shpjegimet që subjekti dha nuk i përgjigjeshin të njëjtës metodologji vlerësimi që kishte përdorur Komisioni dhe, për më tepër, nuk ishin sipas të njëjtës logjikë financiare. Subjekti i rivlerësimit ishte vetëm deklarativ në prapësimet e tij, por nuk arriti të sillte prova të cilat mund të provonin të kundërtën.

2.5 Si rezultat të sa më lart, unë si anëtar në pakicë vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme gjatë viteve për të justifikuar krijimin e depozitës prej 5,500,000 lekësh në “Raiffeisen Bank” dhe krijimin e gjendjes *cash* prej 1,200,000 lekësh, në një balancë negative prej - 2,700,059 lekësh.

2.6 Shumica e trupit gjykues ka pranuar si prova vetëm deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat, në vlerësimin tim si anëtar në pakicë, janë kontradiktore me deklaratën “Vetting”, deklaratat periodike gjatë viteve 2003 – 2016, deklaratimet e bëra gjatë hetimit, si dhe provat e administruara nga hetimit.

3. Automjeti i markës “Ford Explorer”

3.1 Gjatë hetimit administrativ, në deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorit të datës 21.5.2018, subjekti ka deklaruar se ai dhe bashkëshortja e tij kanë përdorur automjetin e markës “Ford”, me targa AA ***, në pronësi të shtetasit A.L., për raste të veçanta udhëtimi, kryesisht për lëvizje familjare.

3.2 Ndërkohë që në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar se përdorin këtë automjet ekskluzivisht.

3.3 Sipas pikës 11 dhe 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

3.4 Neni 4 i ligjit nr. 9049, përcakton si objekt deklarimi pasuritë e paluajtshme dhe të drejta reale mbi to, në pronësi dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

Si konkluzion për sa më lart, unë si anëtare në pakicë vlerësoj se fakti që subjekti i rivlerësimit e ka përdorur shpesh dhe pa ndërprerje këtë automjet, duhet ta kishte deklaruar në deklaratën “Vetting”.

SI PËRFUNDIM, për sa më lart analizova, subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, nuk ka krijuar një nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë, por ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, referuar pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe parashikimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Unë si anëtare në pakicë, bazuar në prova dhe bindjen e brendshme, vlerësoj se shumica nuk duhet të kishte disponuar konfirmimin në detyrë të këtij subjekti, por shkarkimin e tij nga detyra.

Anëtare kundër

Etleda ÇIFTJA